

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE THELLUAR I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË
MJEDIS U HARTUA PËR PROJEKTIN:

**KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE,
PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME
SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M².**

**ME VENDODHJE:
BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA
ORIKUM, RRETHI VLORË.**

Shoqëria Kërkuese:

"Llanaj Ndertim" Sh.p.k

Hartoi raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANagements CONSULTANTS" Sh.p.k

Elidiana Shehu

Administrator



Punoi:

- **Ing. Elidiana Shehu**
(Lic. Nr. Identifikues 146 Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)
- **Ing. Hektor Xhanari**
(Lic. Nr Vendimi 3, Nr. 195 Prot, date 05.04.2007)
- **Ing. Laert Shehu**
(Ing. Mjedisi i Dipl.)

Qershor, 2014

PERMBAJTJE:	FAQE
1. HYRJE.....	3
1.1. Te pergjithshme.....	3
2. KUADRI LIGJOR DHE VNM	5
2.1. Legjislacioni	5
2.2. Permbledhje e kuadrit ligjor.....	6
3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT	8
3.1. Te pergjithshme.....	8
3.2. Qellimi i projektit.....	9
3.3. Vendodhja e projektit.....	9
3.4. Menyra e menaxhimit te mbetjeve inerte qe gjenerohen nga ndertimi...10	
3.5. Menyra e menaxhimit te ujerave te zeza gjate aktivitetit human ne objekte	11
3.6. Afati kohor i nevojshem per ndertimin e ketyre objekteve.....	11
4. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT ZBUTESE PER MINIMIZIMIN E TIJ	12
4.1. Hyrje	12
4.2. Ndikimet ne mjedis te Fazes Ndertimore te objekteve dhe Masat Zbutese te Propozuara	14
4.3. Ndikimet ne mjedis gjate funksionimit te objekteve residenciale dhe masat zbutese te propozuara.....	22
4.4. Te pergjithshme mbi ndotjen e ujit dhe trajtimin e tij	29
4.4.1. Te pergjithshme.....	29
4.4.2. Menyrat e trajtimit te ujerave te zeza.....	Error! Bookmark not defined.
5. PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS	30
5.1. Plani i Monitorimit Social e Mjedisor gjate ndertimit dhe funksionimit .30	
6. REKOMANDIME.....	32
6.1. Rekomandime per investitorin.....	32

1. HYRJE

1.1. Te pergjithshme

Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi jane kushtet me te rendesishme per mbijetesen e njeriut. Ato jane elementet me te rendesishem per zhvillimin e qendrueshem. Me zhvillimin e shoqerise njerezore kerkesat per lende te para dhe produkte nga me te ndryshmet vijne duke u rritur, nderkohe qe burimet natyrore dhe energjia e shfrytezueshme vijne duke u pakesuar. Nga ana tjetere prodhimi i mbetjeve te ndryshme nga konsumi i materialeve ka shkaktuar ndotje serioze ne mjedis, duke rrezikuar mbijetesen e qenieve te gjalla.

Shqiperia ka njohur nje zhvillim ne fushen e turizmit e sidomos pas viteve 90` si ne turizmin bregdetar ashtu edhe ne ate malor. Si pjese e ketij zhvillimi nuk perfshihet turizmi historik, kjo per shkak te mos investimeve dhe mos venies ne funksion te turisteve te shume prej objekteve social-kulturore dhe historike te vendit. Vlen te permendim ketu ekspozimin e kalave me te vjetra dhe me histori te vendit te cilat jane lene ne harrese dhe per me teper jane demtuar rende nga ndertimet dhe faktori natyror. Si cdo zhvillim tjetere edhe ai ne fushen e turizmit ka pasur koston e tij mjedisore, por kjo e fundit duke u ndihmuar nga zhvillimi ne menyre te pa kontrolluar, pa plane e strategji zhvillimi dhe shpesh here edhe jashte kushteve teknike e ligjore te lejimit te ndertimit. Persa i perkete ketij lloji zhvillimi te demshem me mjedisin, shembulli me i mire eshte zona e plazhit te qytetit te Durrës, Vlores, Sarandes dhe vijes bregdetare ne afersi te zonave te urbanizuara. Ndertimet ne keto zona kane shnderruar keto zona nga me pak te frekuentuarat ne vend per shpenzimin e pushimeve verore., duke u shnderruar edhe ne faktor per mos zhvillimin e turizmit bregdetar ne Shqiperi

Nje problem serioz i cilesise se plazheve dhe turizmit bregdetar ne vend jane mungesa e infrastruktures dhe ndotja nga ujerat urbane te perdorura dhe mbetjet e ngurta urbane.

Nje zhvillim te lehte ne vendin tone ka njohur kohet e fundit edhe turizmi malor, duke qene se Shqiperia eshte nje vend me terren kryesisht malor dhe pjeserisht alpine. Vlen te permendim ketu zonen e parkut kombetar te "Lumit Valbone", Tropoje, parku kombetar i "Thethit", Shkoder dhe shume zona te tjera te vendit si parku kombetar "Mali i Dajtit", Tirane, Parku Kombetar "Mali i Tomorrit, ne Skrapar, Parku Kombetar "Liqenet e Lures", Diber dhe nje sere monumentesh natyrore te shperndara ne te gjithë siperfaqen e vendit, te tilla si Ujevara, Shpella karakteristike, Guva, Kanione, Pyje te vecanta, peme te ralla, etj.

KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPERFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M². BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.

Projekti ne vleresim te ketij raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte ndertimi i nje kompleksi rezidencial me objekte individuale banimi 2 kateshe, pishina te hapura dhe te mbyllura, abmjente sportive dhe ambjente sherbimesh si dhe infrastrukturen e nevojshme ne funksion te tyre. Keto objekte do te zhvillohen ne afersi te fshatit Tragjas buze rruges te lidh kete fshat me qytetin e Orikut, territor administrativ i Bashkise Orikum. Kjo qender residencele do te ndikojne ne zhvillimin e turizmit bregdetar ne zonen e rajonit te Orikut dhe specifikisht zona e plazhit, ne vijen bregdetare te detit Adriatik si pjese e Gjirit te Vlores.

Per kete zone eshte kryer edhe Plani i Pergjithshem Vendor nga Bashkia Orikum dhe i miratuar nga Ministria e Mjedisit, Keshilli Kombetar i Rregullimit te Territorit, Keshilli i Bashkise dhe Ministrite e linjes.

Plan-vendosje e objekteve qe do te ndertohen nga subjekti "Llamaj Ndertim" Sh.p.k.



2. KUADRI LIGJOR DHE VNM

2.1. Legjislacioni

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri: "Ligji Per mbrojtjen e mjedisit" dhe "Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis". Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit European per mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky aktivitet, nuk perfshihet ne listat e aktiviteve te cilat duhet te paisen me leje mjedisore te tipit A, B ose C, por duke u bazuar ne kerkesat e Njesive te Qeverisjes Vendore per leje mjedisore dhe raport te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per paisje me Leje Zhvillimore te objekteve te reja qe do te ndertohen, ky projekt eshte klasifikuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit si leje e Tipit B. Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet vetem per fazen e kryerjes se punimeve te ndertimit te objekteve, pasi gjate fazes funksionale, nuk vleresohet me ndikim ne mjedis.

Sipas Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" dhe VKM Nr. 538, date 26.05.2009 "Per licensat dhe lejet qe trajtohen nepermjet QKL, Fusha III, Kategoria III.1, pika 3, ky aktivitet i ndertimit te objekteve, mund te pajiset me Leje Mjedisore te tipit A, B ose C, nenkategoria III.1.C/B/A.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

- VNM e permbledhur.
- VNM i Thelluar.

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si aktivitet me ndikim te vogel ne mjedis, klasifikohet si raport i permbledhur i VNM.

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder ligjet me specifike qe kane lidhje te drejtperdrejte me projektin ne vleresim, mund te permendim:

KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M². BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.

- Ne ligjin Nr. 10 431, date 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" theksohet ne kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

- Ne Ligjin Nr.10 440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" ne kreun II, neni 7 per "Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis" thuhet:

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së dhe licencimi, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin indentifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e drejtperdrejte dhe të terthorte të projektit në mjedisin ku do të zbatohet, si dhe percaktimi i masave për të parandaluar dhe zbutur demtimet në mjedis që në fazën fillestare të tij.

2.2. Permbledhje e kuadrit ligjor

Gjate dhjetevjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore të cilat kanë ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-te dhe zhvillimeve të fundit në fushën e ndërtimit dhe industrisë.

Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) i kushtetutës shkruhet se:

"Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismes dhe të përgjegjësisë private, synon:

Neni d): një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të pershtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Sipas Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", Ministria e Mjedisit është autoriteti përgjegjës për rishikimin e dokumentit VNM të përgatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrisë së mjedisit.

Përveç Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 "Per Vlerësimin

KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M².
BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.

e Ndikimit ne Mjedis". Ky ligj eshte zhvilluar dhe bazuar ne Direktivat e EU dhe praktikat nderkombetare te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë :

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis"**
- **Ligji Nr 8652 Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore, dt 31.07.2000.**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"**
- **Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 "Per planifikimin e territorit"**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".**
- **Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 "Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".**
- **Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të Mjedisit"**
- **Vendimi Nr.247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"**
- **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"**
- **Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"**
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse"**
- **Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"**
- **Vendim Nr. 16, date 14.01.2012 "Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor"**
- **Vendim Nr. 13, date 04.01.2013 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"**
- **Udhezim i Ministrise se Mjedisit nr. 5, dt 28.12.2007 "Per tarifat e sherbimit per Leje Mjedisore".**
- **Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne republiken e shqiperise**
- **Udhezim Nr. 3, date 02.12.2013 "Per Dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore te tipit A, B dhe C per aktivitete te reja dhe ekzistuese".**
- **Rregullore Nr.1, datë 30.3.2007 "Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre"**

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1. Te pergjithshme

Projekti ne vleresim te ketij raporti te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte ndertimi i nje kompleksi rezidencial me objekte individuale banimi 2 kateshe, pishina te hapura dhe te mbyllura, abmjente sportive dhe ambjente sherbimesh si dhe infrastrukturen e nevojshme ne funksion te tyre. Keto objekte do te zhvillohen ne afersi te fshatit Tragjas buze rruges te lidh kete fshat me qytetin e Orikut, territor administrativ i Bashkise Orikum. Kjo qender residencele do te ndikojte ne zhvillimin e turizmit bregdetar ne zonen e rajonit te Orikut dhe specifikisht zona e plazhit, ne vijen bregdetare te detit Adriatik si pjese e Gjirit te Vlores.

Per kete zone eshte kryer edhe Plani i Pergjithshem Vendor nga Bashkia Orikum dhe i miratuar nga Ministria e Mjedisit, Keshilli Kombetar i Rregullimit te Territorit, Keshilli i Bashkise dhe Ministrite e linjes.

Plan-vendosje e objekteve qe do te ndertohen nga subjekti "Llanaj Ndertim" Sh.p.k.



KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M². BUZE RRUGES “TRAGJAS-ORIKUM”, FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORE.

3.2. Qellimi i projektit

Projekti ne vleresim ka si qellim ndertimin e nje kompleksi rezidencial (objekte individuale banimi 2 kate, pishina, ambjente sportive dhe ambjente sherbimesh) dhe infrastrukturen e nevojshme ne funksion te tij. Kompleksi ndodhet prane fshatit Tragjas, buze rruges qe lidhe kete fshat me qytetin e Orikumit, Bashkia Orikum, Rrethi Vlore.

Projekti ka si qellim investimin ne fushen e turizimit, nepermjet ndertimit te infrastruktures se nevojshme per te plotesuar nevojat e turizimit ne Shqiperi. Projekti do te zbatohet ne nje nga zonat me te frekuentuara per turizem bregdetar dhe me cilesine nga me te mirat ne rajon. Projekti do te zbatohet sipas dizenjimit te realizuar nga arkitektet dhe ne perputhje me studimin urbanistik te zones. Do te kryhet nje investim i madh per te relaizuar kushte dhe cilesi bashkekohore.

Ky projekt do te realizohet nga subjekti “Llanaj Ndertim” Sh.p.k dhe do te kete nje siperfaqe totale te prones prej 29980 m² dhe siperfaqe totale te ndertimit prej 5365 m² , koeficienti i ndertimit $K=0.179$, ose 17.9%.

3.3. Vendodhja e projektit

Projekti eshte projektuar te zbatohet ne zonen e prane “Plazhit te Orikumit” ne fshatin Tragjas. Siperfaqja e propozuar per ndertimin e objekteve rezidenciale ndodhet rreth **2km** larg vijes bregdetare, ne anen lindore te rruges nacionale Vlore-Orikum , rreth 1.5 km ne veri-perendim te fshatit Tragjas, buze me rrugen qe lidh kete fshat me qytetin e Orikumit, ne territorin administrativ te Bashkise Orikum, Rrethi Vlore, Qarku Vlore.



KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPERFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M². BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.



3.3.1. Te dhenat teknike te projektit

Siperfaqja e sheshit dhe prones se vene ne dispozicion te ndertimit	S=29980 m².
Siperfaqja e njolles se perbashket te ndertimit	S= 5365 m².
Koeficienti i shfrytezimit te territorit	K_{sh}= 17.9 %.
Siperfaqe e gjelberuar	S= 8374
Koeficienti i gjelberimit	K_{gj}= 28 %

3.3.2. Mbrojtja nga zjarri

Sistemi i mbrojtjes kunder/zjarrit eshte i projektuar te jete i perbere nga nje rrjet i rregullt hidrantesh. Per kete qellim eshte hartuar nje projekt per mbrojtjen nga zjarri ne objekte. Ky projekt do te paraqitet per miratim nga institucionet pergjegjese per monitorimin e cilesise se tij dhe anen funksionale. Pervec ketij sistemi te hidranteve, objektet do te paisen edhe me bombula gazi kunder zjarrit, te cilat do te jene individuale per cdo objekt.



3.4. Menyra e menaxhimit te mbetjeve inerte qe gjenerohen nga ndertimi

Mbetjet inerte do te menaxhohen ne bashkepunim me perfaqesues te Njesise se Qeverisjes Vendore, Bashkia Orikum. Keto mbetje do te depozitohen ne nje zone te caktuar nga Bashkia dhe Keshilli Bashkiak. Nje pjese e ketyre mbetjeve do te sistemohen ne sheshin e ndertimit pas perfundimit te punimeve te hapjes dhe betonimit te themelit.


KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M².
BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.

Do te perdoret per mbushje te aneve te themeleve, per sistemimin e shesheve te parkimit, rruge kalimet dhe siperfaqet e gjelberta.

Mbetjet e ngurta nga punimet e ndertimit do te jene kryesisht ato inerte te cakullit dhe shtreses se humusit dhe shtresa bimore dhe e tokes e cila do te pastrohet per sheshin e ndertimit.

3.5. Menyra e menaxhimit te ujerave te zeza gjate aktivitetit human ne objekte

Sipas projektit te paraqitur, skema e impiantit te trajtimit eshte si me poshte:



3.6. Afati kohor i nevojshem per ndertimin e ketyre objekteve

Afati kohor i nevojshem per te perfunduar punimet e ndertimit do te jete 3 vjet. Kjo ne ritme normale te punes dhe pa marre ne konsiderate faktore te tjere te cilet mund te ndikojne ne vonesa te punimeve, sic mund te jene, problemet ne transport, ne strukturen e tokes, kushtet klimatike, identifikimi i objekteve me rendesi kulturore, etj. Per raste te veshtiresive ne punime, mund te kete edhe shtyrje te afateve te punimeve.

4. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT ZBUTESE PER MINIMIZIMIN E TIJ

4.1. Hyrje

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit te mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Ndikimet kryesore ne mjedis nga ndertimi dhe funksionimi i nje aktiviteti konsistojne ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Shkarkimet ne uje
- Ndikimi ne toke
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e prodhuara
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones
- Ndikim ne ndryshimet klimatike

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi, është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në paragrafin e mësipërm, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjellta.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

Ne baze të këtij vlerësimi, institucioni përgjegjës për mjedisin, merr në shqyrtim dhe kryen verifikimet përkatëse për lejimin ose jo të zhvillimit të një aktiviteti të caktuar.

Institucioni përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe aprovimin ose jo të lejes mjedisore para vendimarrjes së tij, konsultohet edhe me institucione të tjera të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta me projektin ose ndikohen nga ky i fundit. Konsultimi është edhe me i gjere me publikun e ndikuar dhe palet e interesit.

**KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M².
BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.**

4.2. Ndikimet ne mjedis te Fazes Ndertimore te objekteve dhe Masat Zbutese te Propozuara

Ajri			
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese te propozuar	Efekti i mbetur	Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur
Perhapja e pluhurit gjate fazes se ndertimit dhe puneve ne toke (sic eshte psh ndertimi dhe mirembajtja e kompleksit)	Zhvillimi i procedurave per: - sperkatja me uje e rrugeve dhe sheshet e pargjet e materialeve te ndertimit. - mbulimi i automjeteve qe transportojne ngarkesa materialesh per te parandaluar perhapjen e pluhurave nga automjetet. - kufizimet e shpejtesise ne siperfaqet e pashtuara ne zone per te kufizuar ngritjen e pluhurit.	Perhapja e pluhurit do te jete e perqendruar ne zonen e ndertimit dhe nuk do te ndikojte komunitetin vendor. Sidoqofte, punetoret duhet te pajisen me maska kunder pluhurit, vecanerisht ne stine/ dite te thata .	Ndikim negativ mesatar
Ulja e cilesise se ajrit si rrjedhoje e reduktimit te siperfaqeve pyjore.	Rezervimi i siperfaqeve pyjore per hapesirat e lira, kompensimi i siperfaqeve te demtuara ne zona te tjera te vendit te cilat jane problematike. Ndonese projekti ne vleresim nuk prek zone pyjore.	Ulje e cilesise se ajrit te zones, reduktim i prodhimit te oksigjenit nga procesi i fotosintezes. Demtim i siperfaqes pyjore ne moshe te madhe dhe kompensimi ne fidane te rinj.	Ndikim negativ i konsiderueshem, por i menaxhueshem.

**KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M².
BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.**

Zhurmat e shkaktuara nga makinerite ndertuese, makinerive dhe struktures prej betoni e metali.	Perdorimi i paisjeve eficiente, te reja dhe me silenciator. Punimet te kryhen gjate dites per te patur nje eficence me te larte dhe shkurtimin e kohes se punes. Gjithashtu niveli i lejuar i zhurmes eshte me i larte se gjate nates.	Nuk ka efekt te mbetur, zhurmat jane ndikime te perkohshme, kalimtare dhe nuk akumulohen ne mjedis.	Ndikim negativ i ulet
--	--	---	-----------------------

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese te propozuar	Efekti i mbetur	Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur
Shkarkimi/clirimi aksidental gjate transportit i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, vecanerisht ne zonen e ndertimit.	Vendosja e procedurave dhe protokolleve te duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit te materialeve	Potenciali per shkarkimet/clirimet aksidentale gjate transportit te materialeve ne zone do te minimizohet	Ndikim negativ i ulet
Shkarkimi/clirimi aksidental i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, vecanerisht ne zonen e ndertimit, gjate magazinimit	Te gjitha zonat e magazinimit do te kene masat e duhura te sigurise mjedisore per te parandaluar shkarkime aksidentale ne toke.	Potenciali per shkarkimet aksidentale te materialeve gjate fazes se magazinimit ne zone do te minimizohet	Ndikim negativ i ulet

**KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M².
BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.**

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese te propozuar	Efekti i mbetur	Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur
Shkarkimi i mbetjeve te ngurta ne toke gjate punimeve.	Keto lloj mbetjesh, nuk vleresohen me ndikim domethenes ne toke. Ato do te jene ne nivele minimale.	Nuk vleresohet pasi eshte aktivitet me efekte minimale.	Ndikim i paperfillshem
Shkarkimi i ndotesve te lenget ne toke nepermjet ujit, pajisjeve dhe larjes se makinave gjate kesaj faze	Aktivitetet larese do te zhvillohen ne nenzona me kontrolle e procedura te pershtatshme dhe do te monitorohen per te siguruar se masat parandaluese jane eficente.	Potenciali per shkarkimin e ndotesve ne toke gjate aktiviteve larese(psh te mjeteve te tonazhit te rende ndertimore, etj) do te minimizohet	Ndikim negativ i ulet
Rritja e permbajtjes sedimentare te ujit ne receptoret ujore natyrore si rezultat i derdhjes se drejtperdrejte te lendeve	Minimizimi i germimeve gjate fazes ndertimore ne periudha me reshje te dendura	Asnje pasi shkarkimet do te jene ujera te pa ndotur nga substanca te demshme apo ne sasi te larte qe mund te behen shkak i permytjeve/rritje te nivelit te ujit ne permasa te ndjeshme	Ndikim negativ i ulet

**KOMPLEKS REZIDENCIAL (OBJEKTE INDIVIDUALE BANIMI 2 KATE, PISHINA, AMBJENTE SPORTIVE DHE AMBJENTE SHERBIMESH) ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI 5365 M².
BUZE RRUGES "TRAGJAS-ORIKUM", FSHATI TRAGJAS, BASHKIA ORIKUM, RRETHI VLORË.**

Toka dhe uji			
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese te propozuar	Efekti i mbetur	Shkalla e vleresimit te efektit te mbetur
Ndotja e ujrave siperfaqesore si pasoje e rrjedhjes se substancave ndotese	Perdorimi i materialeve ndertimore qe nuk perbejne rrezik per shendetin e njeriut dhe mjedisin Magazinimi i materialeve te mundshme ndotese ne zonat te pershtatshme e mbajtja e tyre nen kontroll. Cdo pjese toke e ndotur gjate fazes ndertimore te hiqet e te depozitohet ne zonat e depozitimit te mbetjeve te rrezikshme nese konstatohen substanca te tilla.	Vleresohet nje efekt minimal. Nese menaxhohen raste te tilla, ndikimi do te ishte i pa perfillshem.	Ndikim i paperfillshem
